



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 6-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 27.09.2022, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 13,<sup>00</sup>

### Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
4. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
5. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
6. Enver Kryeziu, anëtar
7. Idajet Garip, anëtar
8. Zoran Cirkovic, anëtar
9. Ana Guciq, anëtare

### Të tjerë prezent

1. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
2. Visar Kozhani, DBF
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Merita Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

### Të tjerë prezentë

Perfaqesues te KFORIT-Turk

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ftesën me material e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim.

## REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja 5-të e Komitetit për Komunitete
2. Informatë nga DBF për propozim vendimin për aprovimin e buxhetit për vitet 2023-2025
3. Raporti i punës së ZKKK-së
4. Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht me 9 vota aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

## I

### **Aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja 5-të e Komitetit për Komunitete**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstraktit nga mbledhja 5 -të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht me 9 vota për votoi.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

## II

### **Informatë nga DBF për propozim vendimin për aprovimin e buxhetit për vitet 2023-2025**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi ,ia kaloi fjalën Visar Kozhanit, nga DBF, i cili në pika të shkurta i njoftoi rreth kësaj pike.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Zoran Cirkovic, tha pse nuk e kemi materialin nga ana buxhetit në mënyrë tabelore, pasi që nuk po e di se në fshatin Grackë e Vjetër a është përfshi ndonjë projekt e në veçanti rruga kryesore brenda fshatit të cilën e kam ngritur disa herë që 8vite dhe si duket prapë nuk është.

Visar Kozhani, tha se ne e kemi përcjell te Sektori i Kuvendit dhe Sektori e ka përcjell tek ju. Ndërsa sa i përket fshatit Grackë janë disa projekte si , rruga Topliqan Grackë, kanalizimi, ujësjellësi.

Zoran Cirkovic, tha se këtë rrugën unë e kam ngrit që 8 vite në çdo dëgjim buxhetor dhe si duket as në këtë buxhet nuk është marrë parasysh.

Lulzim Qerimi, tha se ne jemi munduar t'i përfshijmë disa çështje të tjera për fshatin Grackë por atë rrugë do ta shohim mundësin ta zgjedhim ose në bashkëpunim me donatorë apo edhe me Ministri .

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se pasi që ajo ka qenë kërkesë e kaherëshme e këtyre banorëve por unë e lë fajtor edhe Zoranin për këtë çështje pasi që ka qenë anëtar i kuvendit për 4 vite , dhe si nuk ka mundur që ta ketë në projekt këtë rrugë.

Shahadije Bikliqi, tha se në çdo dëgjim buxhetor ne kemi ngritur kërkesat tona dhe asnjëherë nuk janë marrë parasysh nga ana e ekzekutivit.

Lumturije Bytyçi-Hasani, tha se ju si nënkryetar duhet t'i dini të gjitha kërkesat e qytetarëve të komuniteteve pasi që jeni që 5 vite nënkryetar i Komunës dhe si nuk keni një listë të nevojave të tyre.

Ana Guciç, tha se sa i përket Janjevës nuk është punuar asgjë.

Skender Bikliqi, tha se edhe unë pajtohna me para folësit se sa i përket Janjevës është punuar shumë pak.

Lulzim Qerimi, tha se unë kam qenë për bashkëpunim me çdo komunitet dhe çdo kërkesë e tyre e cila ka ardhë në komunë unë jam marrë ose personalisht ose së bashku me drejtorët e ekzekutivit jemi munduar që ta zgjidhim çdo problem.

Enver Kryeziu, tha se sa i përket komunitetit ashkali ne jemi shumë të kënaqur me punën që është bërë dhe jemi falënderues ndaj ekzekutivit.

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim.

### III

#### Raporti i Punës së ZLK-së

Lidhur me këtë pikë Ledia Jovanovic, U.D.Shefe e ZLK-së i njoftoj në pika të shkurtëra lidhur me raportin e punës së ZKK-së e ku një kopje e këtij raporti në të dy gjuhët i'u shpërnda edhe nga sektori i kuvendit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin

Zoran Cirkovic, tha se ka qenë një konkurs për OJQ po nuk e di se ka përfituar dikush ose jo!

Ledia Jovanovic , tha se nuk kam informata

Pastaj u kalua në pikën të ndryshme.

### IV

#### Të ndryshme

Zoran Cirkovic, tha se kam për ta ngritur një shqetësim ku në oborrin e shkollës në Grackë disa të rinjë po e dëmtojnë fushën e sportit.

Slavisa Trajkovic, tha se a do të ketë mundësi kompania për pastrimin varrezave të bëjë pastrimin e varrezave pasi që tani ne kemi disa festa?

Lulzim Qerimi, tha se do të diskutojmë me drejtoratët përkatës dhe do të shohim si është mundësia të i'u ndihmojmë.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15<sup>15</sup>.

**Ekstraktin e hartoi**  
**Behar Aliu**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Skender Bikliqi**